



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET
KËSHILLI BASHKIAK

VE D I M

Nr. 33 data 07.05.2026

PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR 26/2026 "PËR DISA SHTESA DHE NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR 69/2012 "PËR SISTEMIN ARSIMOR PARAUNIVERSITAR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË"

Bazuar në Ligjin Nr.139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 5 "Detyrat dhe kompetencat e Këshillit Bashkiak", pika ç, VKM Nr 127 datë 27.02.2026, "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jomësimorë në institucionet arsimore dhe në institucionet plotësuese të sistemit Arsimor Parauniversitar" Ligji nr 26/2026 "Për disa shtesa dhe një ndryshim në ligjin nr 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar ne Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, neni 3, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

VENDOSI:

I. Të miratojë ndryshimet e përcaktuara në nenin 3 të ligjit nr 26/2026 që lidhen me njohjen e diplomës për personelin mësimdhënës/edukator.

II. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

III. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", (i ndryshuar). Efektet financiare të këtij vendimi shtrihen prej datës 01.04.2026 .

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Aleks TANE

KRYETAR
Anila DHIMITRI

